



AKTI I THEMELIT

I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“EL GATO Watersports” SH.P.K



Themeluesit që firmosin më poshtë :

XHAVIT MERTURI , shtetas Shqiptar, i datëlindjes 10/08/1966, lindur në Republikën e Kosovës, banues në Kukës, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Letënjoftim Numër Personal G63310007S, e vlefshme deri 18/10/2027 (Numëri i Leje Qëndrimit Nr.262423 DVKM KUKUËS).

JÖRG ALFRED TITZE, shtetas Gjerman, i datëlindjes 11/06/1968, lindur në Gjermani, banues në 30173, HANNOVER, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i IDD (dokument identifikimi Nr. L2LWPJGV1, Numër personal 734362, e vlefshme deri datë 04/03/2025,

që në vijim do të quhen ‘Ortakë’

Sot. bazuar në vullnetin e tyre të lirë dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14/04/2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, vendosën të themelojnë Shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar. në bazë të kushteve që vijnë:

Kreu I

OBJEKTI, EMËRTIMI, SELIA, RREGJIMI JURIDIK

Neni 1. Objekti i Shoqërisë

Shoqëria ka këtë Objekt të veprimtarisë :

-Aktivitete sportive ujore, me mjete lundruese si banane, ski, etj, në ujë. Organizimin e udhëtimeve turistike me mjete lundruese. Mjete për ski në ujë. Dhënie me qira, shitje, të mjeteve lundruese. Ngritjen e Agjensive Turistike me paketën e plotë të shërbimeve.

-Shoqëria kryen çdo lloj veprimtarie të dobishme, për arritjen e objektit të saj, pjesëmarrje me kuota dhe aksione në shoqëri dhe ndërmarrje të tjera.

Neni 2. Emërtimi dhe Selia juridike e Shoqërisë .

2.1-Ortakët vendosën të emërtojnë Shoqërinë “EL GATO Watersports” Sh.P.K.

2.2-Selia juridike e Shoqërisë ndodhet në Sarandë.

2.3-Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose edhe jashtë vendit.



2.4-Vendodhja e ortakëve në marrëdhënie me Shoqërinë do të jetë ajo që rezulton e shënuar në librin e Shoqërisë.

Neni 3. Rregjimi Juridik

3.1-Shoqëria është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit, si dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3.2-Me vendim unanimitet Ortakët mund të ndryshojnë regjimin juridik të Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas ligjit shqiptar. Në këtë rast Ortakët do të përshtatin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë, si dhe të bëjnë rregjistrimin e saj në rregjistrin tregtar, në organet kompetente shqiptare.

3.3-Shoqëria gëzon personalitet juridik, nga data e rregjistrimit të saj në QKB, në organet kompetente dhe në përputhje me Ligjin.

3.4-Shoqëria do të ketë vulën e saj.

Kreu II

TË DREJTAT DHE DETYRAT, KOHËZGJATJA

Neni 4. Të Drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakëve .

4.1-Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

4.2-Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.

4.3-Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortak në shoqëri ose ndërmarje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

4.4-Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj, duke përjashtuar shprehimisht çdo përgjegjësi personale të çdo ortaku.

4.5-Ortakët përballojnë humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

4.6-Ortakët marrin pjesë në administrimin e veprimtarisë së Shoqërisë në përputhje me Aktin e Themelimit e Statutin, vetë, ose nëpërmjet përfaqësuesve të tij.

4.7-Ortakët kanë të drejtë të marrin të gjithë informatat që kanë të bëjnë me veprimtarinë prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare të Shoqërisë, si bilanci, llogaritë ekonomike, kontratat e lidhura me të tretë, etj .



4.8-Ortakët kanë të drejtë të bëjnë propozime dhe t'i paraqesin ato për shqyrtim para organeve të shoqërisë, si dhe të emërojnë e shkarkojnë administratorin, ose administratorët, punonjësit, ekspertin kontabel apo likuidatorët.

4.9-Ortakët kanë të drejtë të heqin dorë nga Shoqëria duke ia ofruar pjesën e tyre të kapitalit themeltar ortakëve të tjerë. Pjesët e kapitalit mund tu ofrohen të tretëve, vetëm në qoftë se ortakët e tjerë nuk pranojnë t'i blenë ato. Heqja dorë nga Shoqëria nuk e liron Ortakun nga detyrimet financiare të marra më parë ndaj Shoqërisë dhe nuk pezullon detyrimet ndaj ortakëve.

4.10-Çdo ortak ka të drejtë të jetë ortak edhe në shoqëri të tjera, duke plotësuar detyrimet brenda Shoqërisë, të përcaktuar në Aktin e Themelimit, Statutin, dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 5. Detyrimet e Ortakëve .

5.1-Çdo ortak detyrohet të sigurojë plotësimin e drejtë, të plotë dhe në kohë të detyrimeve të veta ndaj Shoqërisë dhe ortakëve të tjerë, në bazë të Aktit të Themelimit, Statutit, legjislacionit në fuqi.

5.2-Kur ortaku nuk i përgjigjet drejtë dhe në mënyrë të plotë detyrimeve financiare ose detyrimeve të tjera, atëherë ortaku tjetër e fton me shkrim që t'i plotësojë ato detyrime brenda 10 ditëve. Nëqoftëse nuk pranon, atëherë ortaku i prekur ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin. Niveli i dëmshpërblimit do të jetë përkatësisht me dëmin e shkaktuar. Ekspertët kontabel mund të caktojnë ekzaktesisht nivelin e dëmshpërblimit.

Neni 6. Kohëzgjatja

6.1-Kohëzgjatja e shoqërisë është përcaktuar 10 (dhjetë) vjet.

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 7.

7.1-Kapitali Themeltar i shoqërisë është 200.000 Lekë (dyqintmije Lekë).

7.2-Kapitali themeltar i ndarë ndërmjet ortakëve të shoqërisë, Numëri i përgjithshëm i kuotave është 2 (dy), Ortakët janë:

a.Ortaku themelues Xhavit Merturi; Vlera e kapitalit 100.000 Lekë; Numëri i pjesëve 1,00; Pjesmarrja në përqindje 50%.

b. Ortaku themelues Jorg Alfred Titze; Vlera e kapitalit 100.000 Lekë; Numëri i pjesëve 1,00; Pjesmarrja në përqindje 50%.



Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajshme, të paluajshme apo të drejta).

Kreu IV

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 8.

8.1-Organ i kryesor vendimarrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve. Mbledhjet e asamblesë thirren jo më pak se dy herë në vit.

8.2-Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme me arritjen e pjesëmarrjes parashikuar në Nenin 86, 87, të Ligjit Nr.9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

8.3-Mbledhja drejtohet nga Administratori i Shoqërisë. Zakonisht emërohet nga pjesëmarrësit një sekretar, me përjashtim të rasteve kur procesverbalin duhet mbajtur nga noteri, sipas ligjit .

8.4-Vendimet e mbledhjes fiksohen në proces-verbalin e firmosur nga Administratori dhe sekretari, ose noteri. Në proces-verbal duhet të përmbliidhen, me kërkesën e bërë prej tyre, deklaratat e bëra prej ortakëve. Vendimet e mbledhjes, të marra në përputhje me ligjin, Aktin e Themelimit, ose Statutin lidhin të gjithë ortakët e Shoqërisë, megjithëse nuk kanë diskutuar ose kundërshtuar.

Kreu V

ADMINISTRIMI

Neni 9.

9.1-Administrimi i shoqërisë do të bëhet në përputhje me Statutin që i bashkëngjitet këtij Akti. Shoqëria do të ketë 2 (dy) Administratorë, të cilët do të veprojnë veç e veç, ose të dy sëbashku Çdo veprim i kryer prej secilit do të ketë fuqi të njëjtë. Administratorë të shoqërisë do të jenë;

a.Z. **JÖRG ALFRED TITZE**, shtetas Gjerman, i datëlindjes 11/06/1968, lindur në Gjermani, banues në 30173, HANNOVER, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i IDD (dokument identifikimi Nr. L2LWPJGV1, Numër personal 734362, e vlefshme deri datë 04/03/2025,

b.Z.**ENVER MERTURI**, shtetas Gjerman, i datëlindjes 06/08/1961, banues në 49843, UELSEN, ITTERBECKER STRABE 22,Gjermani, mbajtes i IDD (dokumenti identifikimi L2HNRFC2R, Numer personal 581833.

Administratoret zgjidhen për një periudhë prej 5(pesë) vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Kreu VI



DISPOZITA TË TJERA

Neni 10.

10.1-Fitimi i realizuar nga shoqëria, mbas shlyerjes së detyrimeve ligjore, do t'u mbetet Ortakëve, sipas përqindjeve të vendosura në kapitalin themeltar të shoqërisë.

10.2-Mosmareveshjet ndërmjet ortakëve, nëqoftëse nuk zgjidhen me mirkuptim, do të gjykohen nga Gjykata kompetente shqiptare.

10.3- Shoqëria fillon veprimtarinë e saj, vetëm pasi të ketë marrë autorizim nga organet kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky Akt Themelimi u përpilua në katër kopje origjinale në të njëjtën vlerë ligjore. Akti Themelimit hartohet në gjuhën shqipe, kuptohet, nënshkruhet në vullnet të lirë, të plotë, sipas ligjit.

ORTAKËT

Xhanit Meritani

Jörg Titze



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ADRIANA J. SOLIS
ADRESA BLV "GJERGJ FISHTA",
NR.88
TEL: 694066803

VERTETIM NENSHKRIMI

(AKT THEMELIMI)

Nr. repertori: 203

Tirane më 04/04/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2024051090015099279

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER ADRIANA J. SOLIS



DATE 04/04/2024
NR REP 203

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 4/04/2024 (Dymije e njezet e katër), para meje Notere ADRIANA J. SOLIS, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, BLV"GJERGJ FISHTA", NR.88, u paraqiten personalisht:

NËNSHKRUES/IT:

1. **Xhavit Merturi**, atësia Rexhep, amësia Hanife, shtetas Shqiptar, lindur në Kosovë dhe banues në Tropojë, me adresë Jah Salihi 02990012; Nd. 28; H. 1; Ap. 10; Bajram Curri; 8701; Tropojë, lindur më 10/03/1966, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 262423 dhe nr. personal G63310007S ,

2. **JORG ALFRED TITZE**, atësia Klaus , amësia Eveline, shtetas gjerman, lindur në Habfurt, Gjermani dhe banues në Hanovver, me adresë: 30173, Hanover, An Der Bismachkschule 2, Gjermani, lindur më 11/06/1968, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaportë nr. C21GW5NLM .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Aktin e Themelimit të shoqërisë Tregetare me Përgjegjesi të Kufizuar "EL GATO Watersport" sh.p.k, bashkëlidhur vërtetimit.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Shetatsi gjerman u sqarua nga une Noterja ne gjuhen angleze ne lidhje me nenshkrimin e aktit te mesiperm dhe rendesine e veprimeve te tij. Ai deklaroi se ne lidhje me aktin e mesiperm eshte konsultuar dhe eshte rene dakord me ortakun per krijimin e shoqerise dhe eshte ne dijeni te plote te veprimeve ligjore para noterit.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.



NOTER
ADRIANA J. SOLIS